



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



KOMUNA E KLINËS  
KUVENDI I KOMUNËS  
01 NR. 06-5958/15  
KLINË, MË 20.7.2015

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT  
I SEANCËS SË VII-të TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR, MË 20.7.2015, NË  
ORËN 10, NË SALLËN E KK

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullorës për rregullimin dhe përbajtje e Simboleve si dhe ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, pllakateve, medaljeve, mirënjojheve, falënderimeve dhe shpërblimeve të tjera,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit-listës plotësuese për emërtimet kontestuese të vendeve nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për sistemin e adresave në territorin e Komunës së Klinës,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planeve të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve:
  - a. Shërbimi i Ndriçimit Publik,
  - b. Shërbimi i Mbrojtjes së Mjedisit-menaxhimi i mbeturinave,
6. Procedurat për Projekt-statutin e QKMF-së si tekstu unik në nivel vendi i dhënë nga Ministria e Shëndetësisë:
  - a. Formimi i Komisionit për shqyrtimin dhe korrigimin e Projekt-statutit të QKMF-së,
  - b. Marrja e vendimit për vënien në diskutim publik të Projekt - statutit të QKMF-së,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për kompensim të Komisionit komunal për Implementimin e programit për adresim të rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshatra të Komunës së Klinës,
8. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

**Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, nënkyretari i komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK, drejtorë të drejtive, Komandanti i Policisë, Rexhë Berisha, OJQ-të, etj.**

Seancën e hapi kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në këtë seancë të Kuvendit. Kryesuesi Ibishi, në vijim i njoftoi anëtarët e Kuvendit lidhur me rendin e propozuar të ditës. Hapi debatin rreth rendit të ditës.

**Skënder Merturi**, tha se desha ta falënderoj Komunën Lekë Bibaj, Republika e Shqipërisë, që këtu ditë ka shpallur Ilir Merturin, “Qytetar Nderi”. Ilir Merturi është dëshmor i kombit i Klinës dhe i Kosovës. Po ashtu njëherësh, falënderoj edhe drejtorët e Komunës, z. Esat Raci dhe z. Enver Marmullaku, për pjesëmarrje në këtë ceremoni të organizuar nga Komuna Lekë Bibaj, të cilët me prezencën e tyre na kanë edhe figurën e këtij dëshmori, organizatorin, por edhe gjithë të pranishmit”, pohoi anëtarri Merturi.

**Haxhi Ibishi**, falënderoi Komunën Lekë Bibaj për këtë mirënjojje që i ka bërë edhe figurës së Dëshmorit të Kombit, Ilir Merturi, luftës së UÇK-së, edhe gjithë dëshmorëve të tjerë të kombit, Klinë dhe Kosovës.

**Prend Buzhala**, tha se kemi qenë të paraparë edhe një grup i caktuar për të marrë pjesë në këtë ceremoni, mirëpo nuk na kanë refuzuar të shkojmë.

**Ndue Shabanaj**, kërkoi që të përmirësohet formulimi i rëndit të ditës, te pikë e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit-listës plotësuese për vendet e emërtimeve kontestuese nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për sistemin e adresave në territorin e Komunës së Klinës. “Mendoj se është dashur një formulim tjeter, “për vendet e emërtimeve” jo, por ishte dashur “për emërtimet kontestuese të vendeve”. Mendoj se logjikisht del kështu. Se nuk është “vendet e emërtimeve”, por është “emërtimi i vendeve” dhe emërtimet janë kontestuese e jo vendet.

Vuri në miratim rendin e ditës me propozimin që e prezantoi këshilltari Ndue Shabanaj.

**Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Haxhi Ibishi, tha se kam arsyetim për anëtaren Violeta Zefi, e cila gjendet në një vizitë zyrtare në Gjermani, për të tjera arsyen nuk kam.

**Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati vërejtje rreth procesverbalit. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

**Me vota unanime u miratua procesverbali i seancës së kaluar.**

**Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për rregullimin dhe përbajtje e simboleve, si dhe ndarjen e tituve të nderit, dekoratave, pllakateve, medaljeve, mirënjojheve, falënderimeve dhe shpërblimeve të tjera.**

**Ali Shala**, zyrtar i lartë i Zyrës Ligjore, informoi rreth procedurave të hartimit të Projekt-rregullores për rregullimin dhe përbajtje e simboleve, si dhe ndarjen e tituve të nderit, dekoratave, pllakateve, medaljeve, mirënjojheve, falënderimeve dhe shpërblimeve të tjera.

“I kemi përfillur iniciativat përkatëse. Keni marrë projekt-rregulloren ku ndryshimet janë të hijezuara. Si Zyrë ligjore e kemi shqyrtuar edhe një herë këtë rregullore. Janë disa ndryshime teknike – juridike dhe përbajtjesore. Projekt-rregullorja i ka paraprirë me takimin me publikun, ku ka qenë një pjesëmarrje solide. Nga ana e qytetarëve janë dhënë vërejtje, sugjerime, propozime, të cilat kanë qenë shumë të arsyeshme dhe janë marrë në konsideratë”, shtoi ndër të tjera zyrtari Ali Shala, i cili në vijim sqaroi nenet të projekt-rregullores. “Jemi komuna e katërt në Kosovë, që bëjmë përpjekje për të hartuar dhe miratuar këtë projekt-rregullore. Është mirë që Komuna jonë ta ketë një rregullore të këtillë”, pohoi zyrtari Shala.

**Haxhi Ibishi**, tha se edhe në KPF anëtarëve ju kem i dhënë mundësi që të vlerësojnë këtë projekt-rregullore nen për nen. Në vijim, Kryesuesi hapi debatin rreth projekt-rregullores.

**Halil Desku**, tha se e kemi diskutuar në KPF dhe jemi dakorduar se nuk ka nevojë të shqyrtohet nen për ne, por ta mbështesim dhe të shkojmë në pako.

**Fadil Gashi**, tha se në KPF nuk kam marrë pjesë, mirëpo nuk do të thotë se nuk jam pjesë e koncezusit. “Por ju duhet të jeni pjesë e konsensusit për këtë tekst që kemi përpara. Këtu dallojmë tash. Këtu ka ndryshime teknike – juridike dhe përbajtjesore. Dhe nëse prej 21 neneve 13 janë me ndryshime, pa hyrë në paragrafe tash. Prej 21 neneve që ka komplet rregullorja 13 janë me ndryshime. Dhe varianti më i mirë këtu do të kishte qenë për t'u kthyer komplet ky dokument, li t'i bëjë përmirësimet ZL, po njëjtë qysh na i prezantojë dhe le të na i bien, sepse ne nuk mund krejt tjetër tekst për të miratuar, ndërsa kur të shkojë te ZL të na dal tërësisht tjetër tekst. Le ta hatrojë këtë tekst qysh e prezantoj këtu ZL dhe atë tekst e votojmë. Zyra ligjore le ta hartojë projekt-rregulloren dhe të na sjellë të pastër për votim. 13 nene kanë ndryshim, që do të thotë më tepër se gjysma”, shtoi ndër të tjera anëtari Gashi.

**Halil Desku**, tha se kemi vendosur ne KPF që e njëjtë rregullore dhe propozimet për t'i sjellur dhe për t'u hijezuar në mënyrë që më me lehtësi mund t'i dallojmë. Domethënë nuk e kemi kërkuar një variant të pastruar tërësisht, prandaj mund të shkojmë edhe nen për nen. Mirëpo, vetë kemi thënë në KPF, se aty jemi të përfaqësuar dhe këtë formë çfarë na është prezantuar e kemi propozuar. Po që se ka faj, ka faj KPF-ja, në KPF jemi të gjithë të përfaqësuar, shtoi prof. Desku.

**Ali Shala**, sqaroi se ju mund të vendosni qysh ju e shihni të arsyeshme, por mund të shkojmë vetëm te nenet që unë i certifikova si ndryshim. Nëse miratohen mirë, nëse nuk miratohen tjetër gjë”, shtoi zyrtari Shala.

**Vlora Tafilaj**, tha se do të isha kundër votimit që propozoi z. Desku, për ta përbledhur në pako, sepse shumica prej nesh nuk kemi qenë në KPF. “deshas për t'u ndërlidhur me fjalën e Abazit, sepse gjatë mandatit tim kam shumë kritika serioze për punën që po bëhet, sepse të njëtin vendim po miratojmë një herë, po e plotësojmë, po e ndryshojmë, do të thotë të njëtin. Kështu që mirë do të ishte ta lëmë si lexim të parë, por duhet për ta votuar kur dokumenti është tërësisht komplet”, shtoi anëtarja Tafilaj.

**Haxhi Ibishi**, tha se partia juaj ka anëtarë në KPF. “Për çështje të rregulloreve ne bëjmë përpjekje që secila rregullore për të qenë më e mire e më e mirë, nuk ka asgjë të keqe, në qoftë se dy-tri herë i kthehemë problematika të njëjtë. Ne i kemi dy forma të procedimit, nen për nen, dhe në qoftë se ka një deklarim të partive politike që t'i inkorporojmë vërejtjet e ZL në tekstin përfundimtar. Për shtyrje të kësaj rregulloreje thjesht jemi në kohën kur vazhdimisht po i shtyjmë këto. Mendoj që kemi kryer punë, punët i ka kryer edhe KPF-ja edhe ZL, prandaj jemi që mund të procedojmë më tutje”, shtoi Kryesuesi.

**Tunë Dedaj**, tha se është mirë me këtë që prezantoi zyrtari i lartë i Zyrës ligjore ta aprovojmë komplet, do të thotë edhe ajo që Pali ka reaguar është sqaruar. “Prandaj, si GP i AAK-së e mbështesim si paket”, shtoi anëtarë Dedaj.

**Prend Buzhala**, tha se më vjen mirë që Komuna ka këtë rregullore. “Kam një pyetje: ka disa vjet që në Klinë nën patronazhin e Kryetarit të Komunës, mbahet një manifestim kushtuar Tahir Deskut, nuk po shoh që figuron ai çmim, pse është hequr?” - pyeti prof. Buzhala.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi se çmimi “Tahir Desku” është me vendim të KK-së. Ka krijuar se Çmim dhe traditë”, sqaroi kryesuesi Ibishi.

**Ali Shala**, sqaroi se mund të shtohet te çmimet.

**Qamile Qitaku**, kërkoi që nëse është e mundur që të shtohet edhe një çmim “Nëna Terezë”, që do të ishte për humanizëm dhe bamirësi.

**Fadil Gashi**, tha se nuk jemi kundër rregullores, nuk jemi të thirrur çfarë na sjellë Zyra ligjore për ta miratuar. “Jemi për procedurat. Kemi kompetenca për ndryshime”, shtoi anëtarë Gashi.

**Halil Desku**, tha se mund të shkojmë me këto 13 nene dhe t'i votojmë në paket. “Në KPF përfaqësojmë të gjitha subjektet politike. Anëtarët e partive që përfaqësojnë në KPF kanë për obligim që anëtarëve të partive që përfaqësojnë t'u shpjegojnë rekomandimet e KPF-së”, tha prof. Desku.

**Haxhi Ibishi**, foli rrëth çështjes në debat.

**Fadil Gashi**, tha se ne jemi pjesë e KPF-së. E kemi problem çështjen procedurale.

**Haxhi Ibishi**, vuri në miratim (në paket) projekt-rregulloren.

Me 24 vota pro dhe 1 abstenim u miratua Projekt-rregullorja për rregullimin dhe përbajtje e simboleve, si dhe ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, pllakateve, medaljeve, mirënjojjeve, falënderimeve dhe shpërblimeve të tjera.

**Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit-listës plotësuese për vendet e emërtimeve kontestuese nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për sistemin e adresave në territorin e Komunës së Klinës.**

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën ia dha kryetarit të Komisionit, z. Zeqir Morina.

**Zeqir Morina**, kryetar i Komisionit për sistemimin e adresave në territorin e Komunës së Klinës në mënyrë kronologjike raportoi rreth Raportit të listës plotësuese për vendet e emërtimeve kontestuese nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për sistemimin e adresave në territorin e Komunës së Klinës.

**Bozhidar Sharkoviq**, prezantoi reagimin lidhur me propozimin e një rruge me emrin e Natasha kandilit. “Ky problem për emërtimin e kësaj rruge ka ardhur sot, nuk di nga ka ardhur propozimi, ndërsa unë sot e kam marrë këtë njofitim. Ajo rrugë nuk ka arsyе për t'u emërtuar me emrin e Natasha Kandiqit. Të gjithë banorët e komunitetit serb të kësaj rruge kanë propozuar që kjo rrugë të quhet “Nikolla Teslla”. Prandaj kërkoj që kjo rrugë të emërtohet me emrin e “Nikolla Teslla”, shtoi anëtari Sharkoviq.

**Pjetër Coli**, tha se emri i Natasha Kandiqit është shumë i qëlluar. “Meritat e saj për paqe janë të pakontestueshme. E njoh personalisht dhe i di vlerat dhe kontributet e saj në aspektin e paqes dhe mirëkuptimit të popujve, pa marrë parasysh përkatësinë nationale. Emërtimi i kësaj rruge me emrin e kësaj humanisteje do të ishte një kompromis. Mendoj që Natasha Kandiq është një personalitetë të cilën e krahasoj me Dimitrije Tucoviqin dhe shumë humanistë të tjere serbë”, pohoi anëtari Coli

**Ramush Agushi**, tha që do të ishte e rrugës që të shkojnë që të dy këta emra dhe Ministria e Planifikimit Hapësinor të vendos, të mos krijojmë konfuzitet.

**Bozhidar Sharkoviq**, tha se pse komisioni nuk na ka konsultuar më herët. “Natasha Kandiqi është vetëm një organizatë joqeveritare asgjë me shumë dhe se ajo asgjë nuk ka bërë për popullin serb dhe njëkohësisht nuk përfaqëson popullin serb. Do t'i falënderoj të gjithë ata që votojnë Nikolla Teslën, ose përndryshe do të tërheq nënshkrimin tim si anëtar i komisionit”, pohoi Sharkoviq.

**Ndue Shabanaj**, tha se kemi dy emra të propozuar dhe i njohim që të dy këto personalitetë. “Konstatimi se njëri nuk ka bërë për popullin serb nuk është i qëndrueshëm. Mendoj se asnjëri nga ne nuk duhet të vijmë në një imponim, siç tha z. Sharkoviq, se tërheq nënshkrimin. Nëse

është të shkohet me dy emra edhe niveli i lartë të përcaktojë se si të emërtohet rruga në fjalë. Ky do të ishte opzioni më racional”, u shpreh profesor Shabanaj.

**Arben Limani**, tha se si komision na ka rënë që gjatë hartimit të listës për t'i ndryshuar emërtimet. “Me këtë rast do të ngreh si shqetësim edhe lidhur me një ankesë që është ndryshuar gjatë hartimit të këtyre listave. Është fjalë për Lumajt, të vrarë me 1913 dhe ky emërtim është ndryshuar me një emërtim me emrin e një martiri të vrarë gjatë luftës së fundit. Ankesa e bërë nga lagja ka qenë më e arsyeshme”, shtoi anëtarri Limani.

**Bozhidar Sharkoviq**, tha se nuk kam asgjë kundër Natasha Kandilit. “Ajo është vetëm përfaqësuese e një organizate joqeveritare. Pse po ndryshohet vullneti i qytetarëve të asaj lagje dhe imi”, shtoi ai.

**Gjokë Lleshaj**, anëtar i komisionit, sqaroi rreth çështjes në debatim. “Në komision jemi pajtuar për Nikolla Tesllën. Aty jetojnë edhe banorë të komitetit shqiptar. Janë dy-tri familje serbe. Kompromisi është edhe i dy komuniteteve aty dhe janë të gatshëm për ta pranuar propozimin për Natasha Kandiqin. Propozimi ka ardhur nga banorët e asaj lagje”, sqaroi anëtar i komisionit, z. Lleshaj.

**Bozhidar Sharkoviq**, tha se ku i keni marrë emrat se a ka më shumë shqiptarë apo serbë. “Nuk është fer të flisni kështu në foltore. Në Videjë ka më shumë serbë, mirëpo kemi bërë kompromis”, shtoi ai.

**Haxhi Ibishi**, tha se ju falënderoj për konstruktivitetin, por edhe ana e anëtarëve kanë treguar konstruktivitet. Askush nuk ka pretendim për të postuar një anëtar të Kuvendit të Komunës”, tha kryesuesi Ibishi.

**Gjokë Lleshaj**, tha se anëtarri Sharkoviq me ka keqkuptuar “Propozimi është i asaj lagje, i atyre banorëve që jetojnë aty”, shtoi z. Lleshaj.

**Bozhidar Sharkoviq**, sqaroi se në atë rrugë jetojnë banorë me shumicë serbe.

**Ndue Shabanaj**, tha se jam përgjigjur atë që them dhe nuk ka nevojë për ta arsyetuar. “ Jam duke e thënë se kërcënimi është vendosje para një akti të kryer. Janë dy emra, kanë meritat nga këndshikimet e ndryshme dhe desha për të gjetur kompromisin që tha z. Ramush. Askush nuk ka asnjë qëllim të caktuar dhe jemi të gjithë në marjen e vendimeve dhe përgjegjësive”, shtoi prof. Shabanaj.

**Tunë Dedaj**, tha se duhet konsultuar rreth kësaj çështjeje.

**Halil Desku**, tha se Natasha Kandiq ka bërë edhe për [popullin e saj, po ashtu njëherësh ka bërë shumë edhe për popujt tjerë. Ajo njihet një nga kontribuueset më të përkushtuara të humanizmit. Propozimi më i mirë ka qenë i Ramushit, në mënyrë që në ministrinë përkatëse të shkojnë që të dy këta emra dhe ata le të përcaktohen për emërtimin”, shtoi profesor Desku.

Pas një pauzë prej gjysmë ore dhe konsultimeve u procedua me seancë.

**Zeqir Morina**, në emër të komisionit konfirmoi se nga konsultimi për patëm doli propozimi që të mbetet emri i Nikolla Tesllës.

**Bozhidar Sharkoviq**, falënderoi komisionin për propozimin.

**Halil Desku**, foli për rëndësinë e dy emërtimeve të propozuara. Profesor Desku po ashtu vlerësoi konstruktivitetin e treguar të komisionit lidhur më propozimin. “E përkrah emërtimin e mëparshëm nga shprehje që z. Sharkoviq dëshiroj të jetë pjesë e politikës komunale, po ashtu edhe nënshkrues i këtij vendimi të komisionit”, shtoi prof. Desku.

**Arben Limani**, tha se edhe në komision e kam përkrahur propozimin për emërtimin e asaj lagje me emrin e Nikolla Tesllës, si emër i shkencës, prandaj, pajtohem me këtë propozim. “Po ashtu, shtoi anëtari Limani, te propozimi i lagjes Lumajt, të shqyrtohet propozimi”, shtoi anëtari Limani.

**Tunë Dedaj**, tha se ju falënderojmë për propozimin dhe konsensusin e arrirë.

**Avni Gashi**, pohoi se e përkrah punën e komisionit, sepse nuk ka qenë lehtë. Edhe Këpuzi të kryehet dhe kjo punë e rëndësishme të përfundojë më sukses. Ne jemi me vendimin e komisionit”, shtoi anëtari Gashi.

**Ndue Shabanaj**, theksoi e jam pro emërtimeve të rrugëve të tjera duke veçuar votën time për rastin konkret. “Dua të kundërshtoj edhe një herë, sepse po më duket shantazh demokratik. Jam kundër çdo shantazhi, qoftë edhe demokratik, prandaj vota ime është për të dy emrat”, shtoi profesor Shabanaj.

**Prend Buzhala**, tha se po më vjen mirë që asamblistët shqiptarë po njohin vlerat e Nikolla Tesllës, emri i tij është më shumë institucion ndërkombëtar, na bën edhe neve këtu. Kam një vërejtje që komisionit të jetë më parimor”, shtoi prof. Buzhala.

**Fadil Gashi**, tha se e përkrahim vendimin e komisionit, mirëpo është mirë që ta sqarojmë këtë çështje. “Te çështja e Lumajve, shtoi anëtari Gashi, komisioni listen paraprakisht e ka prurë me emrin Lumaj, nuk e ka sjellë me emër. Propozimi i dytë është i lagjes. Mendoj që është mirë që të jetë i përgjithësuar dhe kujtoj se më shumë ju flë në hatër kështu se sa me e qitur emrin. Le të jetë “Martirët e Lumajve”, apo Lumajt qysh ka qenë varianti i parë, “Martiret e Lumajve”, edhe ky është pjesë e Lumajve, dhe tash mora informacionin që babagjyshi i tij më 1913 qenka vrarë njëjtë, domethënë në prekë në familje asgjë”, shtoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se në vend të Avdulla Krasniqi, le të quhet “Martirët e Lumajve”.

Komisioni merr në konsideratë propozimin e anëtarit Gashi.

**Ndue Shabanaj**, tha se ne e kemi përmendur edhe atëherë mundësinë e konfliktit të interesit për raste të votimit edhe për këtë çështje. “Dhe, natyrisht nëse askush nuk kundër mund të jetë konflikt interesit po i heshtur. Unë jam që këtë çështje për ta parë kështu se e kemi përmendur dhe realisht nëse ndonjëherë na ka kaluar kështu kjo çështje, mirëpo mua nuk më kalon. Dhe, nuk është dashur të më sjellin në këtë pozicion se dihet që nuk e kam merituar këtë punë dhe në këtë rast nuk është realisht ajo puna ime e lidhur me atë dhe ka qenë një e drejtë legjitime, por unë tash s'po e përjashtoj mundësinë që po trajtohet në forma tjera. Megjithatë një formë kishte për të qenë, secili që në një formë bien ndesh me votimin për konflikt të interesit, këto raste mund të ndahan për t'u votuar në mungesë të një këshilltari”, pohoi profesor Shabanaj.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi procedurat e votimit.

**Skënder Merturi**, theksoi se z. Sharkoviq na qiti në dështim të gjithë anëtarët e Asamblesë Komunale.

**Pal Berisha**, pyeti rrëth emrit të Ndue Përlleshi.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi çështjen e emrit të Ndue Përlleshit. Çështja e emrit të Ndue Përlleshit është vendim i kryer.

Kryesuesi vuri në miratim listën e komisionit.

**Me 21 vota për, 4 të përmbajtur u miratua lista e komisionit.**

**Pika e pestë: . Shqyrtimi dhe miratimi i Planeve të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve:**

- a. Shërbimi i Ndriçimit Publik
- b. Shërbimi i Mbrojtjes së Mjedisit-menaxhimi i mbeturinave

**Haxhi Ibishi**, foli rrëth çështjes në shqyrtim. Fjalën ia dha z. Gjokë Lleshaj, drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente.

**Gjokë Lleshaj**, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente në mënyrë kronologjike raportoi rrëth Planit të Veprimit për përmirësimin e shërbimeve: Shërbimin e ndriçimit publik dhe Shërbimi i Mbrojtjes së Mjedisit – menaxhimit të mbeturinave. “Pas miratimit të këtij Plani pritet edhe implementimi, ku faza e parë do të jetë diku në muajn gusht. Edhe Kryetari e ka nënshkruar participimin në këto projekte”, shtoi drejtori Lleshaj, i cili në fund të prezantimit të raportit kërkoi që të miratohet nga ana e anëtarë të Kuvendit.

**Vlora Tafilaj**, tha se vend për shumë kritika për planin e veprimit, mirëpo unë po lidhem këtu te grumbullimet e mbeturinave. Jam anëtar e Komitetit për Shërbime Publike, Gjoka e di sa ankesën e ka pasur prej qytetarëve të qendrës së Klinës dhe nuk mendoj që shërbimet kryhen në qendër në baza ditore, ndërsa në lagje një herë në javë. Unë kisha propozuar që gjatë muajve të verës, e kemi propozuar edhe në Komitet, të merren bile parasysh këto kërkesat e komitetit, të

pakten gjatë muajve të verës, sepse qyteti nuk është në gjendje të mirë dhe shërbimet duhet të kryhen në baza ditore, mirëpo ne e dimë në baza ditorë sa kryhen këto shërbime”, shtoi anëtarja Tafilaj

**Lorenc Marleku**, tha se sa i përket ndriçimit, nuk e di a është shkuar kah ajo që nëse është qyteti as është specifikuar se kah do të jetë ai ndriçim apo është vetëm plan global se cilat pjesë të qytetit janë të parapara në këtë projekt, sepse lagja jonë “Arbëria”, është pjesë e qytetit dhe deri aty ka ardhur ndriçimi, mirëpo ajo pjesë e rrugës nuk është e ndriçuar”, theksoi anëtarin Marleku.

**Ndue Shabanaj**, theksoi se ndriçimi është në favor të sigurisë së qytetarëve. Ndriçimi duhet të jetë në të gjitha zonat e qytetit. Mendoj që është e nevojshme për ta pasur një plan të përgjithshëm. Sa i përket mbeturinave, mendoj që është mirë të futet në sistemin e menaxhimit ndërtesor. Kjo shkon në favor të shëndetit të popullatës”, pohoi prof. Shabanaj.

**Halil Desku**, tha se dëshiroj për ta uruar drejtorin e Shërbimeve Publike për punën që ka bërë. “Sa i përket projektit e kam parë që nuk është gjithëpërfshirës, është një projekt i tij, që ka arritur për ta përfituar një donacion për ndriçimin dhe menaxhimin e mbeturinave. Qytetarët do të përfitojnë në realizimin e këtij projekti. Dokumenti duhet miratuar”, shtoi profesor Desku.

**Haxhi Ibishi**, tha se ky është plan veprimi. “Kuvendi duhet dhënë dritën e gjelbër për të vepruar”, shtoi Kryesuesi.

**Vlora Tafilaj**, tha se qytetarët paguajnë shërbimet, prandaj është e obligueshme që edhe ato të kryhen me përgjegjësi.

**Rasim Millaku**, tha se besoj se në grafikon mendoj se është gabim teknik. Janë të prezantuar dy tabelarë, prandaj kisha dashur që ta shikojë drejtori i SHP apo kush e ka punuar këtë. Prezantohet përqindja e kilometrave në ndriçim publik në zonat urbane. Është ngatërrim, sepse në vitin 2011, ka një përqindje të kilometrave më të madhe, në vitin 2012, ndërsa ne viti 2013 më pak. Ngjashëm shkon edhe të kënaqshmëria. Më lart është i ngritur vitit 2012, përkatësisht 2011, 2012, ndërsa ne fund të tabelorit vjen viti 2013”, theksoi anëtarin Millaku.

**Tunë Dedaj**, tha se falënderoi Drejtorinë e Shërbimeve Publike për grumbullimin e mbeturinave nëpër fshatra, kjo shihet dhe preket. “Kisha kërkuar që ndriçimi të shkojë edhe nëpër fshatra, përkatësisht vendbanime që meritojnë ndriçimin”, shtoi anëtarin Dedaj, i cili në vijim kërkoi që të bëhet pastrimin i lumit Drini i Bardhë.

**Gjokë Lleshaj**, sqaroi çështjet e interesimeve të anëtarëve. Drejtori Lleshaj, sqaroi edhe çështjen e tabelorit.

**Rasim Millaku**, theksoi se është gabim teknik.

**Enver Berisha**, nënkyetari i Komunës, tha se falënderoi grupin punues për këtë plan, ku sipas nënkyetarit Berisha, është një plan mjaft ambicioz dhe me perspektivë. Në vijim nënkyetari Berisha, po ashtu foli cdhe rrëth bashkëpunimit me USAID-in. “USAID-i do të bashkëpunojë edhe me projekte të tjera. Ky është një fillim i mirë për ne”, shtoi ndër të tjera nënkyetari Berisha.

**Fadil Gashi**, theksoi se në këtë plan ka shënim paushalle. “Në dokumente shënim paushalle nuk duhet pasur. Të mos na sillen dokumente paushalle”, theksoi anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, foli rrëth dokumentit. “Dokumenti na obligon për të marrë vendim të përgjegjshëm”, shtoi Kryesuesi.

Kryesuesi vuri në miratim dokumentin.

**Me 24 vota për, 1 kundër u miratua dokumenti.**

**Pika e gjashtë:** Procedurat për Projekt-statutin e QKMF-së si tekstu unik në nivel vendi i dhënë nga Ministria e Shëndetësisë:

- a. Formimi i Komisionit për shqyrtimin dhe korrigjin e Projekt-statutit të QKMF-së,
- b. Marrja e vendimit për vjenie në diskutim publik të Projekt - statutit të QKMF-së.

**Haxhi Ibishi**, foli rrëth çështjes në rend të ditës.

**Fadil Gashi**, theksoi se duhet të merret vendim për ndryshimin e Statutit të QKMF-së. “Është rregull që ka qenë dhe duhet të jetë”, shtoi anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se duhet për t'u shfuqizuar ish-Statuti i QKMF-së.

**Ali Shala**, zyrtar i lartë i Zyrës komunale Ligjore, foli rrëth çështjes në shqyrtim. “Numri të jetë 5”, shtoi zyrtari Shala.

**Ali Shala**, kërkoi që të mos përsëriten emrat.

U propozua komisioni profesional për korrigjin e harmonizimin e tekstit të Projekt—statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – Akt Unik ky për të gjitha institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor të Kosovës me specifikat që dallon QKMF\_në “Nënë Tereza” në Komunën e Klinës, nga komunat tjera. Komisioni u propozua në këtë përbërje:

1. Dr. Ali Ahmetxhekaj
2. Qamile Qitaku
3. Dr. Filloreta Berisha
4. Dr. Hekuran
5. Xhemajl Rraci

**Kryesuesi vuri në miratim komisionin.**

**Komisioni u miratua me vota unanime.**

**Pika e VII: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për kompensim të Komisionit komunal për Implementimin e programit për adresim të rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshatra të Komunës së Klinës.**

**Haxhi Ibishi**, prezantoi kërkesën e Komisionit komunal për kompensimin e punës së kryer rreth implementimit të programit për adresim të rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshatra të Komunës së Klinës.

**Halil Desku**, tha se komisioni për punën e bërë duhet kompensuar. “Komisioni duhet paguar në këtë shumën që kanë kërkuar, sepse kanë bërë një punë tepër të rëndësishme dhe me shumë përgjegjësi. Prandaj, jam në dakord që edhe kompensimi t'u bëhet sipas vlerës së punës që kanë bërë. Komitetet konsultative nuk janë duke u paguar. Mendoj që duhet të paguhen, sepse edhe ashtu buxheti për t'u kompensuar këto komitete është ndarë”, shtoi profesor Desku.

**Tunë Dedaj**, tha se do ta kisha mbështetur që komisioni të kompensohet, mirëpo jo në vlerën që ata kanë kërkuar. “Vlera e kompensimit që kanë kërkuar është tepër e lartë, mirëpo mendoj që shuma prej 300 euro do të kishte qenë e arsyeshme”, pohoi anëtari Dedaj.

**Fadil Gashi**, tha se e përkrahim shumë e kërkuar. “Aty ku ka bazë ligjore duhet përfillur”, shtoi ndër të tjera anëtari Gashi.

**Ndue Shabanaj**, tha se jam pro pagesës së këtij komisioni. “Nuk ka punë që nuk kompensohet, prandaj edhe kjo punë tepër e rëndësishme duhet të kompensohet. Mendoj që është mirë që kur të formohet komisioni të përcaktohet edhe pagesa. Jam që pagesa të bëhet sipas kërkesës që ka bërë komisioni”, shtoi prof. Shabanaj.

**Rasim Millaku**, tha se është mirë që ekzekutivi të deklarohet rreth mundësive të pagesës dhe pastaj të diskutojmë. Vitin e kaluar është votuar buxheti. Nuk jam për të votuar po që se nuk ekzekutohet. Në fillim të përcaktohen gjera”, theksoi anëtari Millaku.

**Skënder Merturi**, tha se ne veç sa formuam një komision, a do të paguhet? “Është mirë që të dimë a kanë mundësi për t'u paguar. Shuma e kërkesës së komisionit prej 500 euro është e lartë. Në mund të bëjmë punë edhe në baza vullnetare. Është mirë të na tregohet në fillim, a paguhemi apo jo”, theksoi anëtari Merturi.

**Pjetër Coli**, tha se dëshiroj ta bëj një apel. “Do ta votoj, por kemi një vërejtje, që komisioni për ndarjen e banesave ka pasur punë tepër të madhe, diku për 6 javë, mirëpo për punën dhe angazhimin e bërë nuk është kompensuar. Nuk është në rregull që një komision të paguhet, ndërsa një tjetër të mos paguhet. Megjithatë kërkesa e komisionit po u vu në miratim do ta votoj”, shtoi anëtari Coli.

**Fadil Gashi**, foli rreth kompensimit të anëtarëve te komisionit. “Puna është e përcaktuar me ligj, nuk është punë vullnetare. “ Punët duhet kompensuar. Po thërras për respektim të procedurave. Kudo paguhet komisionet. Kërkoj të respektohen procedurat, asgjë më shumë”, shtoi anëtari Gashi.

**Tunë Dedaj**, shtoi se paratë janë të taksapaguesve. Komitetet obligative nuk janë paguar. Shumën prej 500 euro nuk do ta votojë, ndërsa prej 300 euro po”, theksoi anëtari Dedaj.

**Fadil Gashi**, tha se po flas për komitetet, për të gjitha jam pér t'i kryer kërkesat ligjore.

**Ramiz Rrusta** (drejtor i Drejtorisë pér Financa, Ekonomi dhe Zhvillim), foli rreth kompensimit të komisioneve dhe komiteteve. “Buxheti pér vitin 2015 është miratuar vitin e kaluar, mirëpo, megjithatë po dalin edhe shpenzime të paparashikuara. Do të kërkojmë nga Ministria si ta bëjmë kompensimin pér komisionet. Kemi formuar komisione që nuk dimë se çka punojnë. Mendoj që shtë mirë t'ju japim përparësi atyre që nuk kompensohen nga buxheti”, theksoi drejtori Rrusta.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjeve në debatim. “Të gjenden format pér zbatim të ligjshmërisë”, shtoi dr. Ibishi.

Vuri në miratim kërkesën.

Me 19 vota pér, 1 kundër dhe 2 të përmbajtur u miratua kërkesa e komisionit komunal pér implementimin e programit pér adresim të rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshatra të Komunës së Klinës.

**Pika e tetë: Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.**

**Arben Limani**, theksoi që si GP i LDK-së kërkoj në seancën e radhës të hyjë si pkikë e veçantë e rendit të ditës, Shqyrtimi i Raportit të Audimit të Përgjithshëm. “Ky rapport të të prezantohet në asamblenë komunale dhe të shqyrtohet”, shtoi anëtari Limani.

**Tunë Dedaj**, tha se kisha pér ta ngritur shqetësimin rreth furnizimit të qytetarëve me ujë. “Jemi e vëtmja komunë që nuk kemi ujë. Kemi pesë lumenj, mirëpo ujë nuk kemi. Kërkohen pagesat, mirëpo ujë nuk ka, jo vetëm në qytetin e Klinës, mirëpo edhe nëpër fshatra”, shtoi ndër të tjera anëtari Dedaj.

**Skënder Merturi**, tha se kam disa pyetje: Pse nuk ka transmetim të seancave në Radio Alba? Pse kryetari nuk vjen në punë? Pse nuk merren masa rreth rriqgrave, rreth mungesës së ujit, pér auditim, pse nuk është thirrur takimi me publikun pér Raportin 6-mujor të Kryetarit, a kontrollon kush lokalini Sumer Love, që të mos ketë zhurmë dhe njerëz nën moshën 18 vjeç” etj.

**Shukrije Shala**, ngriti shqetësimin e rrugës së fshatit Qeskovë. “Kërkoj që në rrugën e fshatit Qeskovë të vendosen policët e shtrirë. Ajo rrugë, po ashtu ka nevojë pér shenja të komunikacionit”, shtoi anëtarja Shala.

**Prend Buzhala**, theksoi se në kuadër të Komunës vepron edhe Këshilli për Siguri. “Prej tyre deri me tash nuk kemi dëgjuar asnjë fjalë. Nga elektorati i PSHDK-së kemi informata për thyerje të shtëpive të banimit. Pse lejohen këto forma paralele të veprimit. Mendoj që është e rrugës që të shqyrtohet gjendja e sigurisë nga ky Këshill i Sigurisë. Po ashtu, shtoi prof. Buzhala, është e rrugës që gjatë kësaj kohe të verës ndërsa mërgimtarët tanë kthehen në vendlindje, të riorganizojmë ndonjë veprimtari kulturore”, shtoi prof. Buzhala.

**Halil Desku**, foli rreth atributave të kryetarit të Komunës së Klinës, z. Sokol Bashota. “Kryetari i Komunës, z. Sokol Bashota është kryetar i Komunës, ka shërbyer si deputet dhe ministër i jashtëm, i ka sjellë Klinës shumë të mira, prandaj nuk ka nevojë që përherë të jetë në Klinë”, shtoi prof. Desku.

**Elvira Sejdiu**, tha se pse që dhjetë ditë nuk është bërë mbledhja e mbeturinave.

**Enver Berisha**, foli rreth disa shqetësimeve që i preokupojnë banorët e Sferkës. “A ka mundësi që komuna të ketë ndriçimin edhe nëpër lokalitete të tjera përpos qytetit të Klinës, që Hidrodrini të lëshojë ujin në ujësjellësin e Sferkës?”

**Enver Berisha**, nënkyrytar i Komunës së Klinës, iu përgjigj interesimeve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi Ibishi, falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Kryesuesi seancën e konstatoi të përfunduar.

Seanca përfundoi në orën 13.00.

Procesmbajtës,  
Mikel Gojani

*Mikel Gojani*

